

**UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**  
**PROGRAMI MASTER**  
**MËSIMDHËNIE DHE KURRIKULA NË ARSIMIN FILLOR**



**TEZA MASTER**

**Përjetimi i ngjyrave tek fëmijët**

Mentori:

Ligj. PhD. C. Ahmet Ibrahim

Kandidate:

Arbesa Thaqi

Gjilan, 2024

Mbrohet para Komisionit vlerësues të përbërë nga:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit vlerësues:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

## **DEKLARATË E AUTORËSISË**

Unë, Arbesa Thaqi kam shkruar këtë punim akademik me titull “Përjetimi i ngjyrave tek fëmijët”, dhe deklaroj se ky punim është produkt i punës sime origjinale. Unë konfirmoj se kam përdorur burime të ndryshme, të cilat janë të cituara dhe të referuara në përputhje me rregullat e citimit dhe standardet e përcaktuara nga Fakulteti i Edukimit.

Gjithashtu, deklaroj se nuk ka ndonjë konflikt interesi apo shkelje e etikës shkencore në lidhje me këtë punim.

### **Statement of authorship**

I, Arbesa Thaqi, have written this academic paper entitled " Experiencing colors on children", and I declare that this paper is the product of my original work. I confirm that I have used various sources, which are cited and referenced in accordance with the citation rules and standards set by the Faculty of Education.

Also, I declare that there is no conflict of interest or violation of scientific ethics in relation to this paper.

*Babait.....*

*Për të mbushur mungesën e cila më shoqëron çdo ditë, për këto momente që do të do doja të ishte prezent!*

## **FALËNDERIM**

*Shfrytëzoj rastin të falenderoj familjen time për mbështetjen e deri më tanishme, veçanërsiht nënën time për të gjitha sakrificat e saj!*

*Faleminderit stafit të Fakultetit të Edukimit për punën dhe përkushtimin e tyre!*

*Falenderim i veçantë shkon edhe për Mentorin e temës Prof. Ass. Dr. Ahmet Ibrahimimi për konsultat dhe mbështetjen, këshillat për punimin dhe realizimin e temës!*

## **ABSTRAKT**

*Ngjyra është element shumë i rëndësishëm e sidomos tek fëmijët që shpesh- herë është edhe alfabeti i tyre. Ky studim shqyrton dhe merret veçanërisht me rëndësinë, ndikimin dhe përjetimin e ngjyrave tek fëmijët.*

*Gjatë prezantimit tim do të njihemi edhe më tej me disa çështje si: efektet e ngjyrave tek fëmijët, si ndikojnë ngjyrat në trurin e fëmijëve, përjetimi i ngjyrave tek fëmijët. Më pas edhe rëndësinë e ngjyrave në arsim.*

*Si dhe në përfundim do të kemi hulumtimin e kësaj teme, rezultatet e këtij hulumtimi, rekomandimet për prind dhe mësuesdhënës.*

*Hulumtimi është realizuar në dy shkolla të Ferizajt, në shkollën “Vezir Jashari” dhe në shkollën “Enver Topalli”. Si mostër janë marrë nxënësit e klasës I-V.*

*Sipas të dhënave nga analiza e rezultateve të hulumtimit është nxjerr si përfundim se ngjyrat janë element më se i rëndësishëm për fëmijët dhe se ndikimi i tyre është në shkallë të lartë.*

**Fjalët kyçe:** ndikim, ngjyrë, fëmijë.

## **ABSTRACT**

Color is a very important element, especially for children, which is often also their alphabet. This study examines and deals specifically with the importance, influence and experience of colors in children.

During my presentation, we will learn more about some issues such as: the effects of colors on children, how colors affect children's brains, the experience of colors in children. Then the importance of colors in education.

As well as at the end, we will have the research of this topic, the results of this research, recommendations for parents and teachers.

The research was carried out in two schools in Ferizaj, in the "Vezir Jashari" school and in the "Enver Topalli" school. The students of class I-V were taken as a sample.

According to the data from the analysis of the research results, it is concluded that colors are more than important element for children and that their influence is high.

**Key words:** influence, color, children.

## PËRMBAJTJA

DEKLARATË E AUTORËSISË .....	3
FALËNDERIM .....	5
ABSTRAKT .....	6
ABSTRACT .....	7
I. HYRJE.....	10
Qëllimi i hulumtimit .....	10
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	12
III. Ngjyra .....	14
Efekti psikologjik i ngjyrave.....	15
Efekti i ngjyrave tek fëmijët.....	20
IV. Si ndikojnë ngjyrat tek fëmijët?.....	22
Si ndikojnë ngjyrat në trurin e fëmijëve si i përjetojnë ato? .....	23
Ngjyrat lehtësojnë sytë dhe mendjen .....	24
Rëndësia e ngjyrave në arsim.....	24
Efekti i ngjyrës në vëmendje dhe në mësim .....	27
V. METODOLOGJIA .....	28
Popullacioni dhe mostra.....	28
Procedurat .....	28
Metodat e hulumtimit.....	28
Metoda përshkruese: .....	28
Metoda krahasuese:.....	28
Metoda demonstruese: .....	29
Instrumenti .....	29
VI. Analiza e hulumtimeve.....	30
SHKOLLA I.....	30
Klasa I: .....	30
Nxënësi I: .....	30
Nxënësi II.....	31
Klasa II:.....	32
Nxënësi I: .....	32



Nxënësi II:.....	33
Klasa III .....	34
Nxënësi I: .....	34
Nxënësi II.....	35
Pyetësor- Klasa IV .....	36
Nxënësi I.....	36
Nxënësi II.....	36
Pyetësor- Klasa V.....	38
Nxënësi I.....	38
Nxënësi II.....	39
SHKOLLA II .....	40
Klasa I .....	40
Nxënësi I:.....	40
Nxënësi II.....	41
Klasa II.....	42
Nxënësi I: .....	42
Nxënësi II:.....	43
Klasa III .....	44
Nxënësi I: .....	44
Nxënësi II.....	45
Klasa IV .....	46
Nxënësi I: .....	46
Nxënësi II.....	47
Klasa V .....	48
Nxënësi I: .....	48
Nxënësi II.....	49
Rezultatet e hulumtimit të paraqitura me anë të diagrameve:.....	50
VII.    Përfundimet .....	55
VIII.   Rekomandimet.....	57
Referencat e literaturës së shqyrtuar.....	58
Shtojcat .....	63

## **I. HYRJE**

Fëmijët janë qenia më e çmuar në botë, të punosh me ta është një privilegj dhe njëkohësisht mision në vete. Për të kuptuar botën e tyre duhet të bëhesh “bashkëmoshatar i tyre”. Bota e tyre është me plot ngjyra prandaj dhe kam zgjedhur temën e cila ka të bëjë me ngjyra dhe përjetimin e ngjyrave tek ta.

Zakonisht në jetën e përditshme në përgjithësi njerëzit e veçanërisht fëmijët përdorin ngjyrat për të dalluar gjësendet në bazë të karakteristikave si: gjinisë, ftoftësisë-nxehtësis, gëzimit, hidhërimit, etj...

Pra ngjyra është element që na përcjell kudo dhe kurdo.

Zakonisht që nga mosha kur fëmijët fillojnë të zhvillojnë vetëdijen aty fillon edhe diferencimi (veçimi) i ngjyrave nga fëmijët. Që nga kjo moshë fillon të zhvillohet një bindje tek fëmijët për dallim gjinor që vajzat duhet të vishen me rozë (pembe) dhe djemtë me blu (kaltër). Duke u rritur ky dallim apo kjo bindje fillon të zhvillohet më shumë zakonisht gjatë shkollës fillore.

Ngjyra është njëra prej attributeve më të dukshme të botës që na rrethon. Për foshnjat dhe fëmijët, kuptimi i ngjyrave është njëra prej gjërave esenciale në ndërtimin dhe zhvillimin e tyre...

Ngjyrën e takojmë në gjitha anët rreth nesh, në natyrë, në objektet dhe gjithçka që ekziston në botë, kanë ngjyrë. Ngjyra shihet vetëm kur ka dritë, natyrore apo artificiale.

Pa dritë nuk ka ngjyrë.

### **Qëllimi i hulumtimit**

Qëllimi i këtij studimi është që të analizojë botën e ngjyrave tek fëmijët, ndikimin dhe rëndësinë që kanë ato për jetën e fëmijëve. Përmes këtij punimi, unë kam realizuar edhe një hulumtim përmes të cilit dëshirojmë të ngrisim rekomandimet tona në lidhje me gjetjet dhe mundësitë më të mira për përshtatjen e ngjyrave dhe zhvillimin e imagjinatës së fëmijëve për përdorimin e tyre në shprehjen figurative. Ky hulumtim është realizuar në rajonin e Ferizajt, me nxënës të ciklit të ulët 1-5, duke përfshirë të dy gjinitë.

Objektivat:

- o Të sintetizoj konceptin ngjyrë
- o Të analizoj përjetimin e ngjyrave tek fëmijët
- o Të kuptoj nëse realisht ekzistojnë dallime gjinore gjatë përdorimit të ngjyrave

### **Pyetjet e hulumtimit**

- I. Çfarë ngjyra preferojnë nxënësit (fëmijët)?
- II. Sa janë në gjendje nxënësit e klasës së parë deri në klasën e pestë të shprehin imagjinatën e tyre përmes artit figurativ në përdorimin e ngjyrave?
- III. A e ndjejnë se ka diferencim gjinor përmes ngjyrave?

### **Hipotezat**

H1: Ngjyrat kanë rëndësi të madhe në jetën e fëmijëve, sidomos në të shprehurit e imagjinatës së tyre.

H2: Nxënësit nga klasa e 1-5, janë në gjendje të shprehin imagjinatën e tyre përmes artit figurativ, respektivisht përmes përdorimit të ngjyrave.

H3: Edhe tani në vitin 2024 bëhet diferencim gjinor gjatë përdorimit të ngjyrave.

## II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Koncepti i ngjyrës është një koncept i gjerë për këtë arsye kam shfrytëzuar literature të ndryshme përfshirë autor të ndryshëm dhe lëmi të ndryshme.

Ngjyra është koncept që përveç artit prek shumë edhe degën e psikologjisë. Psikolog të ndryshëm kanë dhënë mendime të ndryshme për të kuptuarit dhe rëndësinë së ngjyrave.

Të kuptojmë perceptimin e ngjyrave në psikologji. Kuptimi i ngjyrave në psikologji varion nga kultura apo rrethanat.

Çdo ngjyrë ka aspektet e veta.

Komunikimi jo gjuhësor (jo-verbal)

Ngjyra është një formë komunikimi jo verbal, nuk është një energji statike dhe kuptimi i saj mund të ndryshojë nga njëra ditë në tjetrën si dhe nga çdo individ në tjetrin. Varet pra se çfarë energji shpreh në atë pikë kohore.

Psh nëse dikush vesh ngjyrë të kuqe një ditë, kjo mund të ketë kuptim se ky person është gati për aksion, ose është i apasionuar pas diçkaje që do bëjë atë ditë, ose ngaqë është i nevrikosur, të gjitha këto si në nivel ndërgjegjësor (koshient) apo nën-ndërgjegjësor (subkoshient) Por të gjitha këto tipare janë tiparet e ngjyrës së kuqe.

Ashtu sikurse besohet për numrat dhe format e manifestimit mistik të ndikimit të tyre në jetën tonë të përditshme, jo vetëm urtësitë e lashta të civilizimeve të ndryshme, por edhe psikologjia jonë bashkëkohore, vlerëson rëndësinë e madhe të ndikimit të ngjyrave në krijimin e efekteve të ndryshme psikike dhe gjendjeve të caktuara emocionale dhe shpirtërore në përgjithësi.

Se ngjyrat, vërtet, kanë një ndikim të pamohueshëm në gjendjen tonë emocionale, atë mund ta ndjeni edhe vetë. Humori juaj fare nuk do të jetë i njëjtë në një ambient ku dominon ngjyra e kuqe dhe aty ku do të dominojë ndonjë ngjyrë tjetër më e çiltër.

Mu për këtë qëllim edhe arkitektët e enterierit të hapësirave publike dhe banesore, gjithnjë përkujdesen që dhomat dhe ambientet me dedikime të ndryshme, të kenë ngjyra të caktuara. E njëjta gjë është edhe me rrobat që ne i veshim. Edhe këtu, ngjyrat e kanë rolin e tyre vendimtar,

si në shkaktimin e gjendjes së humorit në ne, ashtu edhe te krijimi i efekteve të caktuara tek të tjerët.

Që nga koha e Babilonisë së vjetër, astrologët kanë besuar se çdo planeti i takon një ngjyrë e caktuar dhe ajo, në mesin e shumë elementeve tjera, luan një rol të rëndësishëm në komentimin parathënës për shenjën e caktuar.

P.sh. Diellit, i ka takuar e verdha e arit dhe e portokallta; Hënës, ngjyra e bardhë; Marsit, e kuqja e mbylltë; Merkurit, i kanë takuar tonet neutrale dhe jeshil e çelët; Venerës, jeshil e mbylltë dhe e kaltra; Jupiterit, e kaltra dhe ngjyra vjollcë.

Përveç astrologjisë, urtësia e lashtë çifute Kaballeja, manipulon shumë me ritualin e ngjyrave. Sipas saj, vizualizimi mental i ngjyrës së caktuar dhe paralelisht shqiptimi i fjalëkalimit adekuat verbal, arrihet në gjendje transi, gjatë së cilës mund të kontaktohet me nivele të lartësuar hyjnore.

Edhe urtësitë tjera të lashta, sikurse janë: magjia, hermetizmi, okultizmi, alkimia etj., të gjitha ritualet e veta i mbështesin në veprimin e domethënies së simbolikës së ngjyrave.

Ndikimet e ngjyrave në hapësira të caktuara dhe në gjendjen e përgjithshme emocionale të njeriut, ata kanë përpiluar tabela të veçanta të klasifikimit të tyre, të cilat i ruanin si fshehtësi. Në përgjithësi, popujt e lashtë ngjyrat i kanë klasifikuar si: ngjyra me ndikime pozitive, dhe ato që kanë ndikim negative.

### III. NGJYRA

Arti figurativ i njohur ndonjëherë edhe si figurativizëm, përshkruan vepra arti (veçanërisht piktura dhe skulptura) të cilat shihet qartë se rrjedhin nga burimet e sendeve apo gjërave të vërteta dhe në këtë mënyrë është edhe reprezentativ (përfaqësues). Termi në fjalë është shpesh në kontrast me artin abstrakt. Që nga paraqitja e artit abstrakt, termi figurativ është përdorur për t'iu referuar çdo forme të artit modern që mban referenca të forta në botën reale. Arti figurativ nuk është sinonim i pikturës së figurave (arti që përfaqëson figurën njerëzore), megjithëse figurat njerëzore dhe shtazore janë subjekte të shpeshta.

Ngjyrat janë veçori e dritës, nga e cila njeriut i është vënë në dijeni nëpërmjet receptorit të syrit për praninë e objekteve ose të burimeve të dritës.

Ngjyra është një ndjenjë e cila jetës i shton ngazëllim dhe emocione. Kur fillojmë të pikturojmë, mësojmë se ngjyra nuk është gjë tjetër vetëm ndjeshmëri ndaj dritës e kapur nga retina e syrit. Sa më shumë dritë aq më e ndritshme është ngjyra.

Të gjitha gjërat që na rrethojnë, që nga rrobat që i veshim deri te pikturat që i shohim kanë të bëjnë me ngjyrat.

Natyra është e pasur me ngjyra të shumëllojshme. Objektivisht dihet se syri ynë mundë të dalloj qindra llojesh ngjyrash dhe nuancash. Duke u mbështetur në bazë të zbulimeve shkencore dihet se në natyrë ekzistojnë dhe mund të dallojë syri ynë afro 5000 mijë lloje ngjyrash dhe tonësh nga më të ndryshmet. Mundësimi që ne ti shohim ti ndjejmë dhe ti përjetojmë përmes shqisave të t'pamurit këtë lloj ngjyrash dhe nuancash na mundëson ndriçimi i diellit. Fizikani i njohur Anglez Isak Njutoni në vitin 1794 në bazë të një eksperimenti vërtetoi se drita e diellit përbëhet prej shtatë rreze ngjyrash. Gjithë këta shtatë rreze ngjyrash i kemi quajtur ngjyrat e spektrit diellor. Drita e diellit për të cilën mendohej se përbëhej prej një ngjyre nga dukuria natyrore, pikat e shiut, nëpër të cilat depërtojnë rrezet e diellit krijojnë një dukuri të bukur të cilën ne quajmë ylber. Vargu magjik i ylberit përbën spektrin magjik të ngjyrave.

Radhitja e ngjyrave të spektrit magjikë të ylberit është si vijon:

1. E kuqja
2. E portokallta
3. E verdha

4. E blerta
5. E kaltërta
6. Violetë (manushaqe)
7. Vjosë (indigo)

Secila ngjyrë ka simbolikën e saj që në vete ngërthen një kuptim apo një domethënie, si :



**Ngjyra e kuqe:** simbolizon dashurinë, trimërinë, i jep energji zemrës (e njohur si e kuqja shëruese).



**Ngjyra portokalli:** simbolizon shkëlqimin, famën, etj...

Është ngjyrë që bien në sy, stimulon mushkëritë, frymëmarrjen dhe tretjen.



**Ngjyra e verdhë:** simbolizon tradhtinë, xhelozinë, melankolinë.




**Ngjyra e gjelbër:** simbolizon gjallërinë, natyrën, jetën. Sjell harmoni dhe baraspeshë psikologjike dhe emocionale. Stimulon paqen e brendshme. Forcon sistemin nervor.



**Ngjyra vjollce:** simbolizon: besimin, krenarinë, virtytin.



**Ngjyra e zezë:** tregon zgjuarsinë dhe vetësigurinë



**Ngjyra e bardhë:** paqen.

## Efektet psikologjike të ngjyrave

Efektet psikologjike të ngjyrave është i madh te personat që kanë prirje të lindur për harmoninë e ngjyrave. Disa ngjyra qetësojnë dhe ne e ndiejmë veten të pushueshëm, disa të tjera shqetësojnë

dhe ne e ndiejmë vetën më të lodhur. Ngjyrat zgjojnë ndjenja të ndryshme, disponimi përkatës për secilën nga to, varësisht nga efekti që arrin ngjyra në shpirtin e njeriut. Ka edhe njerëz që nuk i përjetojnë ngjyrat fare. Ata u përkasin personave që nuk kanë talent apo nuk kanë shije të lindur për bukurinë e ngjyrave. Shoqëria e zhvilluar i kushton rëndësi të posaçme ambientit të njeriut. Varësisht nga puna që kryhet në një hapësirë me ngjyra përkatëse rregullohet edhe ambienti për punë, për pushim ose për aktivitete të ndryshme të punës, si psh. ngjyra e verdhë zgjon ndjenja të ngrohta, përtërin, nxit aktivitetin intelektual, ngjyra e portokalltë ngazëllen, nxit aktivitetin për punë.

Është thënë se mënyra se si ne e shohim veten ndikon në mënyrën se si ne e shohim botën. E kundërta është gjithashtu e vërtetë. Si e shohim botën tonë mund të ndikojë në mënyrën se si ne e shohim veten. Kjo është arsyeja pse zgjedhja e ngjyrave në muret e dhomës së ndenjes ose ngjyra e veshjeve tona luan një rol në përcaktimin e gjendjes shpirtërore ose aftësisë për të përpunuar informacionin.

Sipas Bross dhe Jackson (1981), ngjyrat e shkollës që pëlqehen mirë nga nxënësit do të kenë një efekt në tensionin e muskujve, si dhe aftësitë e kontrollit motorik. Shumë studime të tjera kanë treguar gjithashtu se ngjyrat e ftohta ndikojnë dhe ulin presionin e gjakut. (Wohlfarth, 1986; Sydoriak, 1987; Hathaway, 1988; Faily, 1979). Ngjyrat që ndikojnë në presionin e gjakut si dhe ritmin e zemrës së zemrës janë të rëndësishme pasi ato rrisin hapësirën e vëmendjes së fëmijëve, gjë që nga ana e saj përfiton të mësuarit. Një rënie në presionin e gjakut dhe sjellje agresive gjithashtu është vërejtur, madje edhe tek fëmijët me vështirësi në shikim, si rezultat i ndryshimeve të bëra në ngjyrat e përdorura në mjedis. (Wohlforth dhe Sam 1982).

Sipas studiuesve në fushën e psikologjisë së ngjyrave, çdo ngjyrë ka një gjatësi valore magnetike që rrit ose pengon të mësuarit. Ngjyrat me gjatësi valore të ulëta janë relaksuese dhe ngjyrat me gjatësi valore të gjata janë më aktive.

Pra, cilat ngjyra ndihmojnë përpunimin intelektual? Sipas studiuesve (Wohlforth dhe Sam 1982), ato janë: jeshile, e kaltër dhe portokalli.

E gjelbërt

Si një ngjyrë me gjatësi vale të ulët, jeshilja krijon relaksim. Mendoni për një livadh të gjelbër ose pemë.



Një studim i drejtuar nga Dr. Kate Lee, ekzaminoi 150 studentë të universitetit. Ajo i dha grupit një detyrë të mërzitshme, monotone që tërhoqi hapësirën e tyre të vëmendjes në një pikë thyerjeje, duke shtypur një seri numrash pa pushim ndërsa lexonin në një ekran kompjuteri. Studentëve u është thënë të mos shtypni tastet kur numri tre u shfaq në ekran. Pastaj erdhi koha e pushimit dhe në një dritare prej 40 sekondash të gjysmës së grupit shikuan një çati të gjelbër, ndërsa të tjerët shikuan jashtë në një çati të zhveshur prej betoni. Hulumtimet treguan se studentët që shikuan pamjen e gjelbër bënë më pak gabime dhe kishin përqendrim të përgjithshëm më të mirë.

Dr Lee arriti në përfundimin se çatia e gjelbër ofronte një 'përvojë restauruese' e cila ndihmoi në rritjen e burimeve mendore të studentëve të përfshirë në studim.

E kaltërta

E kaltërta është gjithashtu një ngjyrë me gjatësi valore të ulët. Çelësi është të gjesh hijen e duhur të të kaltërs për të mësuar optimale. E kaltër e errët e bën një person të mjerë, kështu që është më mirë të përdorni një aludim të një ngjyre energjike si portokalli. Nxënësit me mbingarkesë njohëse kanë nevojë për këtë ngjyrë për të ruajtur produktivitetin.

E portokallt

Teoricienët e ngjyrave deklarojnë se portokalli rrit oksigjenin në tru duke stimuluar kështu aktivitetin mendor. Furnizimi i rritur i oksigjenit energjizon dhe rrit çdo përvojë mësimore.

Ashtu si jeshile, hijet e portokallit duhet të zgjidhen me kujdes në mënyrë që mbivlerësimi të mos ndodhë. Angela Wright, një psikologe, beson se ngjyrimet më të guximshme të portokallit mund të çojnë në mbivlerësim, kështu që ata nuk do të ishin zgjedhje të mira për nxënësit.

Nga ana tjetër, portokalli me ngopje të ulët i mban nxënësit të qetë dhe të përqendruar. Madje përmirëson funksionimin nervor. Kështu që do të ishte një mënyrë e mirë që të përdoret në klasë. Por kjo nuk ndodh edhe me ngjyrën e kuqe. Përgjigjet ndaj ngjyrës janë shkencore (fiziologjike) dhe emocionale (psikologjike).

Studimet (Engelbrecht, 2003; Morton, 1998) në lidhje me efektet fiziologjike kanë treguar ndryshime në presionin e gjakut, tendosjen e syve dhe zhvillimin e trurit. Për shembull, ekspozimi ndaj ngjyrës së kuqe shkakton që zemra të rrah më shpejt, rrit presionin e gjakut etj. Në të kundërt, e kaltërta e shkakton një normë më të ngadaltë të pulsit, temperaturë më të ulët të trupit dhe ulje të oreksit (Engelbrecht,2003).

Përgjigjet psikologjike ndaj ngjyrës përfshijnë ndryshime në humor dhe vëmendje (Engelbrecht 2003; Shabha, 2006). Truri lëshon një hormon i cili ndikon në disponimin, qartësinë mendore dhe

nivelin e energjisë kur ngjyra transmetohet përmes syve (Engelbrecht, 2003). Për shembull, ngjyra rozë mund të shtypë sjelljen agresive tek të burgosurit (Walker, 1991). Është interesante, ndikimi i ngjyrës është jo i kufizuar në aspektet vizuale pasi gjatësia e valëve të ngjyrave thithen nga lëkura (Torice & Logrippo, 1989). Wohlforth dhe Sam (1982) gjithashtu e mbështetën këtë pretendim në studimin e tyre.

Gjetjet tregojnë se ndryshimet në ngjyrën e mjedisit rezultuan në një rënie të presionit të gjakut dhe ulje në sjelljen agresive tek fëmijët.

Disa përgjigje me ngjyra janë të përkohshme dhe të tjera mund të zgjasin për një periudhë të gjatë kohore. Shumë reagimet janë të menjëhershme (Morton, 1998). Një numër studimesh kanë eksploruar ndikimin e ngjyrës në klasë (Engelbrecht, 2003; Grangaard, 1995; Imhof, 2004; O'Connor et al., 1990; Wilkins, 2003).

Hulumtimi i kryer nga Torice dhe Logrippo (1989) ka treguar që fëmijë aktiv preferojnë ngjyra të ftohta dhe fëmijët pasivë janë më të rehatshëm të rrethuar nga ngjyra të ngrohta. Morton, 1995 pohon se pastërtia dhe kontrasti me ngjyrat e tjera është më e rëndësishme se ngjyra. Me fjalë të tjera, një jeshile e fortë mund të stimulojë një individ më shumë se një e kuq të fortë (Morton, 1998). Për më tepër, sasia e ngjyrës duhet të merret parasysh në hartimin e mësimit fizik. Sasi të mëdha të ngjyrave mbivlerësojnë individët pa marrë parasysh ngjyrën ose preferencën. Verghese (2001) diskuton procesin e kërimit vizual dhe vëmendjes në lidhje me teorinë e zbulimit të sinjalit. Kjo teori thotë se mendja njerëzore vazhdimisht përpiqet të organizon një informacion vizual. Shumë ngjyra, lëvizje ose modele funksionojnë si shpërqendruar që bëjnë që kërkitimi vizual të jetë më i vështirë. Një mjedis mësimor stresues do të rezultojë nga përdorimi i tepërt i ngjyrës. Grangaard (1995) hulumtoi efektet e ngjyrës dhe dritës në të mësuar për nxënësit 6-vjeçar. Sjelljet jashtë detyrës dhe presioni i gjakut u matën në dy kushte mjedisore. Klasa e parë kishte mure të bardha dhe drita fluoreshente të bardha të ftohta. Një klasë e dytë ishte modifikuar me mure blu të lehta dhe drita me spektër të plotë. Gjetjet treguan se sjelljet jashtë detyrës

u ul me 22 përqind në dhomën e modifikuar. Për më tepër, leximet e presionit të gjakut treguan një ulje nëntë përqind në klasën e dytë. Një studim i kryer në 1993 nga Boyatzis & Varghese i ndjekur nga studime të mëpasshme në 2001 dhe 2003 tregoi marrëdhënie midis preferencave të ngjyrave dhe performancës së studentëve. Kolori ka 3 attribute themelore: ngjyrim, vlera dhe ngopje. Ngjyra klasifikohet gjithashtu bazuar në temperaturën e saj. Sytë e njeriut nga ana tjetër kanë shufra dhe kone që ndihmojnë në dallimin e ngjyrave të ndryshme. Kur ngjyra kalon nëpër qelizat retinale në

sy, qelizat e receptorit thithin ngjyrimet dhe dërgojnë një sinjal në tru, ku deshifrohen ngjyrat. Këto impulse të trurit bien gjithashtu në hormonet që rregullojnë gjëndrat endokrine të cilat më pas evokojnë përgjigje emocionale dhe psikologjike. (Studimi Nielson dhe Taylor i 2007). Për shumë vite psikologët klinikë kanë ofruar supozime rreth domethënies emocionale të ngjyrës. Dekada më parë, Goldstein (1939) pretendoi se ngjyrat specifike nxisin përgjigje emocionale specifike. Klinikët kanë pohuar se përdorimi i ngjyrave në art nga fëmijët, për shembull, është një manifestim i statusit të tyre emocional. E kuqja shoqërohet me zemërim, agresion, ngacmim; e gjelbërtë qetësi, tërheqje; ngjyra të zeza dhe të tjera të errëta me depresion ose ankth ( Birren, 1978; Shape, 1974). Megjithëse klinikët supozojnë të dinë rëndësinë emocionale të ngjyrës për fëmijët, si ndihen vetë fëmijët për ngjyrën? Në një studim (Cimbalo, Beck, & Sendziak, 1978), në klasën e dytë dhe të tretë u prezantuan me fotografi të skenave që gjyqtarët i kishin vlerësuar më parë si të lumtur apo e trishtuar. Ndërsa fëmijët shikonin secilën fotografi, u kërkohet të ngjyrosnin në një formë me një ngjyrë të zgjedhur të tyre. Kur shikonin skena të lumtura, fëmijët përdorën portokalli, të verdhë, jeshile dhe blu, ndërsa kur shikojnë skena të trishtueshme fëmijët kanë tendencë të përdorin kafe, të zezë, dhe të kuqe. Një studim i hershëm (Lawler & Lawler, 1965) zbuloi se parashkollorët ngjyrosën me të verdhë pasi dëgjuan një histori të lumtur dhe me një shkumës kafe pasi dëgjoji një histori të trishtuar. Në një studim më të ri (Buckalew & Bell, 1985), u treguan figura të një djali dhe një vajze, me veshje që ishin me ngjyrë blu, jeshile, të kuqe, të verdhë, të bardhë, të zezë, ose kafe. Fëmijëve iu kërkua të vizatonin fytyrat në secilën figurë, dhe studiuesit pastaj vlerësuan shprehjen e fytyrës së secilit vizatim si të lumtur, të trishtuar ose indiferent. Studiuesit zbuluan se fëmijët nuk bazojnë emocione specifike në ngjyrat e veshjeve. Fëmijët priren të vizatonin fytyra të lumtura, pavarësisht nga ngjyra e veshjes e personazhit. Nuk kishte dallime gjinore në emocionet që lidheshin me ngjyra.

## Efekti i ngjyrave tek fëmijët



*Fig.1*

Ngjyrat ndikojnë në funksionet trupore, mendjen dhe emocionet me energjinë e prodhuar nga drita. Efekti i ngjyrës është i madh te personat që kanë prirje të lindur për harmoninë e ngjyrave. Studimet e kryera qartë tregojnë përfitimet e ngjyrave ku zhvillohet truri, kreativiteti, produktiviteti dhe të mësuarit.

Efektet e ngjyrës në qeniet njerëzore mund të ndryshojnë; duke shkaktuar ngacmim, duke u dhënë hua, duke dhënë frymëzim, duke ngritur ankth ose tension ose duke dhënë paqe, janë disa nga këto efekte. Kur ngjyrat qetësojnë ne e ndiejmë vetën të pushueshëm, mirëpo kur ata shqetësojnë ne e ndiejmë veten të lodhur. Ngjyrat zgjojnë ndjenja të ndryshme varësisht nga efekti që arrin ngjyra në shpirtin e njeriut. Ka njerëz që nuk i përjetojnë ngjyrat fare. Ata u përkasin personave që nuk kanë talent, apo nuk kanë shije të lindur për bukurinë e ngjyrave. Këto efekte mund të vërehen më qartë tek fëmijët. Fëmijët mund të jenë më të ndjeshëm ndaj ngjyrave.

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme të zgjidhni ngjyrat e përshtatshme për fëmijët. Duke përdorur një ngjyrë të kuqe intensive në dhomë, të një fëmije të shqetësuar, ose duke i veshur me rroba të kuqe ose duke u dhënë atyre një çantë shpine të kuqe, mund ta bënte atë më të shqetësuar dhe të tensionuar. E njëjta gjë vlen edhe për fëmijët shumë aktivë.

Kur energjia e kuqe e ngjyrave përdoret në ose rreth një fëmije shumë aktiv, kombinimi mund të çojë në një fëmijë që është tepër aktiv gjatë gjithë ditës. Kjo gjithashtu mund të ndikojë negativisht në suksesin e tyre arsimor. Do të ishte më e përshtatshme për të përdorur blu, jeshile dhe vjollcë në sendet e fëmijëve energjik dhe të shqetësuar.

Është gjithashtu e nevojshme të jetë veçanërisht e ndjeshme në hartimin e dhomave të fëmijëve. Natyrisht çdo dhomë në shtëpitë tona është e rëndësishme, megjithatë dhoma e fëmijës duhet të jetë tërheqëse dhe zbavitëse, me elemente që do të kontribuojnë në edukimin e tij dhe zhvillimin e trurit të tij. Në zgjedhjen e ngjyrës së murit për dhomat e tyre, duhet të përqipemi të mbrojmë pamjen e fëmijëve, t'u sigurojmë atyre një mjedis të përshtatshëm studimi, të mbrojnë shëndetin e tyre fizik dhe mendor dhe të krijojnë një mjedis të favorshëm për një gjumë të rehatshëm.

Dhomat e gjumit mund të jenë të rëndësishme së zakonshme për prindërit. Megjithatë, për një fëmijë, është një vend ku ai fle, luan vetë dhe shpenzon kohë me miqtë e tij / saj.

Sa më e vogël të jetë moshë e fëmijës aq më e thjeshtë duhet të jetë dekorimi i dhomës së tij/saj.

#### IV. SI NDIKOJNË NGJYRAT TEK FËMIJËT?

Ngjyrat janë mjete më të zakonshme të përdorura nga fëmijët për të shprehur emocionet dhe mendimet e tyre. Përveç ndikimit në gjendjen shpirtërore, emocionet dhe veprimet tona, ngjyra gjithashtu ndikon në ambientin e një hapësire, si dhe sa i madh apo i vogël, ftohtë apo ngrohtësisht është perceptuar.

Shoqëria e zhvilluar i kushton rëndësi të posaçme ambientit të njeriut . Varësisht nga puna që kryhet në një hapësirë , me ngjyra përkatëse rregullohet edhe ambienti për punë, për pushim ose për argëtim . . .

Megjithatë preferencat e fëmijëve tregojnë një bashkësi të përgjithshme të bazuar në grup moshat, zgjedhjet e tyre të ngjyrave mund të ndryshojnë në bazë të disponimit të tyre, mënyrës si shprehin veten dhe ndjenjat e tyre.

Fëmijët duhet të arsimohen në fusha që mbështesin krijimtarinë dhe imagjinatën e tyre. Për shkak të faktit se klasat janë mjete më të rëndësishme për t'i shërbyer këtij qëllimi, ato renditen më kryesorja ndër faktorët që kërkojnë më shumë vëmendjen tonë.

Lidhjet në tru nuk janë përfunduar në një fëmijë deri në moshën 5 deri në 6 vjeç dhe ata marrin 1 vit më shumë për t'u pjekur. Për shkak se nuk janë në gjendje të lexojnë dhe të shkruajnë në këtë moshë, ata mbështeten më shumë në material vizual për të vendosur komunikimin. Kështu ngjyra është një mjet i rëndësishëm i shprehjes për ta.

Pamja fillon të zhvillohet pas muajit të 6-të në foshnje dhe zhvillimi vazhdon deri në moshën 10 vjeç. Pamja është një nga shqisat më të rëndësishme që na lidh me botën. Dritë dhe ngjyra kanë një efekt hipnotik tek ne. Mesatarisht, syri i njeriut mund të perceptojë 150 ngjyra të ndryshme në dritë të dukshme. Kjo do të thotë që një person me pamje normale mund të dallojë mes miliona ngjyrave të ndryshme. Ngjyra është një nga karakteristikat më të rëndësishme që mund të na ndihmojë të vlerësojmë dhe përcaktojmë një objekt. Secili dhe çdo person ka disa reagime të ruajtura në perceptimet e tyre dhe si e tillë perceptimi i çdo ngjyre adreson emocionin e lidhur.

Ashtu si për të gjitha qeniet njerëzore, fëmijët janë edhe qeniet intelektuale "psikologjike dhe fiziologjike". Fëmijët i përdorin shqisat e tyre për të lehtësuar komunikimin me mjedisin e tyre. Ata përdorin ndjenjën e syve të tyre së bashku me dritën dhe ngjyrat, si dhe faktorë të tjerë vizualë

mjedisorë, për të komunikuar. Sipas studimeve kërkimore, ngjyra ka rëndësi të madhe në zhvillimin e aftësive kognitive dhe motorike të fëmijëve.

### **Si ndikojnë ngjyrat në trurin e fëmijëve si i përjetojnë ato?**



*Fig.2*

Varësisht nga gjendja në të cilën ato përdoren, ngjyrat mund të shkaktojnë efekte pozitive ose negative. Çdo ngjyrë që përdoret vetë në një dhomë me shpresën e krijimit të një efekti pozitiv, mbart mundësinë e shkaktoimit të një reagimi negativ në vend. Duke qenë subjekt i stimujve të tepruar mund të shkaktojnë ndryshime në frymëmarrjen, pulsën, presionin e gjakut dhe tensionin e muskujve. Nga ana tjetër, stimuj shumë pak mund të çojnë në ankth, paaftësi, reaksion të tepruar emocional, humbje përqendrimi dhe nervozizëm.

Për të dhënë një shembull, një mjedis krejtësisht i bardhë çon në mungesë të stimulit dhe kjo, në kundërshtim me pritjet, nuk shkakton efekt të ekuilibruar ose neutral.

Padyshim që përveç dallimeve gjinore që bëhen zakonisht përmes ngjyrave është vërejtur dhe shkenctarisht që burrat dhe gratë përjetojnë dhe reagojnë ndaj ngjyrave ndryshe. (Kjo është vërejtur gjatë matjes së pulsit nga EEG).

Ndërsa është vërejtur se puls i një fëmijë qetësohet në një dhomë të pikturuar me blu ose me rozë.

Kur ngjyra transmetohet nga syri në tru, truri liron një hormon që ndikon në emocionet, qartësinë e mendjes dhe nivelet e energjisë. Efektet negative dhe pozitive psikologjike të ngjyrave mund të vërehen tek qeniet njerëzore bazuar në kombinimet në të cilat përdoren. Ndërsa foshnjat ndjehen të pazgjdhura në një dhomë me ngjyrë kryesisht të verdhë, ata mund të ndjehen të qetë në një dhomë të pikturuar në një kombinim të ngjyrës blu, të gjelbër dhe të verdhë.

## Ngjyrat lehtësojnë sytë dhe mendjen

Syri sheh në natyrë ngjyrat e objekteve por pikturon ngjyrat e shpirtit. Edhe shpirti i njeriut ka ngjyrat e veta. Këto ngjyra bazohen në ngjyrat natyrore, por formësohen sipas ndjenjave që krijuesi ndien ndaj ngjyrave.

Tendoja e syrit tregon veten në ndezje të vazhdueshme të syve, si dhe zgjerimin e irises kur drita dhe ngjyra intensiteti është statike. Kjo çon në një reduktim të aftësisë për t'u përqendruar në objekte dhe vështirësi në diferencimin ndërmjet objekteve të vogla.

Zgjedhja për të pikturuar muret e kundërta ose anësore të një klase në ngjyrat inkurajuese do të ngushëllojë sytë e tendosur. Qëllimi këtu është për të siguruar që sytë e fëmijëve të ngushëllohen kur ngrenë kokën nga puna që bëjnë ata, në mënyrë që ata përsëri të bëhen të aftë për të përqendruar vëmendjen e tyre. Studimet tregojnë se muret me të cilat fëmijët vendosin të pamurit kryesisht duhet të jenë në ngjyra që nuk janë të errëta. Nga ana tjetër, kur muret me të cilat ata kanë më pak kontakt me sy janë pikturuar me ngjyra të errëta, monotonia do të thyhet dhe studentët do të nxiten më shumë.

## Rëndësia e ngjyrave në arsim

Në zgjedhjen e ngjyrave në fushën e arsimit, është e rëndësishme të zgjidhni ngjyrat funksionale në vend të atyre estetike. Në një hapësirë me shumë stimuj, shqisat janë të mbingarkuara. Në kundërshtim me këtë, ngjyrat e përdorura në disa vende mund të shkaktojnë stres ose mund të kenë aq pak efekt stimulues se ata nuk mund të inkurajojnë produktivitetin. Me fjalë të tjera, mungesa e stimujve nganjëherë mund të jetë aq e dëmshme sa që të ketë të tepërt. Studimet e kryera tregojnë se dallimet personale si dhe gjinia duhet të merren në konsideratë në zgjedhjen e ngjyrave për të siguruar që ata përfitojnë të mësuarit.



U zbulua në një studim shkencor të kryer nga Sinofsky dhe Knirck (1981) që ngjyrat ndikojnë në sjelljen, qëndrimin, vëmendjen e vëmendjes dhe të nxënësve, si dhe konceptin e kohës së studentëve dhe mësuesve. Sipas këtij studimi, ngjyra e një klase mund të ndikojë në shkallën që studentët janë në gjendje të absorbojnë informacionin. Studimet e kryera kohët e fundit dhe në të kaluarën tregojnë se ngjyrat më të lehta janë më mbështetëse për mësimin në krahasim me ato më të errëta.

Rice (1953) thekson se suksesi akademik i nxënësve të shkollave të fëmijëve dhe të shkollave fillore ndikohet më pozitivisht kur ngjyrat janë planifikuar me kujdes. Sipas një studimi tjetër, ngjyrat e zgjedhura në shkolla mund të krijojnë një atmosferë depresive dhe monotone, si dhe një atmosferë të lumtur, emocionuese dhe nxitëse. Është vërejtur se ngjyrat shkollore të zgjedhura me kujdes mund të krijojnë një efekt pozitiv. Disa studime tregojnë se drita e emetuar nga ngjyra të ndryshme mund të ndryshojë presionin e gjakut, pulsën, frymëmarrjen, aktivitetin e trurit dhe biorhythms. (Gruson, 1982) Fëmijët kërkojnë aktivitete dhe fusha të lojërave përmes të cilave mund të lirojnë zemërimin e tyre, shqetësimet emocionale dhe ndryshimin e disponimit. Brenda këtij konteksti, ngjyrat e ngrohta mund të përdoren për të rritur aktivitetin dhe ngjyrat e ftohta për relaksim dhe arritjen e qetësisë.



Fig.3

Përveç faktorëve fizikë në një klasë, si ngjyra e mureve, madhësia e dritareve dhe vendosja e tavolinave, energjia e mësuesve është gjithashtu e rëndësishme. Nëse një mësues nuk është i motivuar ose është negativ në sjellje kjo do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në studentë.

Për këtë arsye, ngjyrat kanë ndikim edhe tek disponimi i mësuesit dhe luajn rol të rëndësishëm tek ta! Nëse mësuesi përballet dhe sheh një ngjyrë muri nxitëse gjatë gjithë ditës, ai / ajo mund të bëhet i tensionuar pas njëfarë kohe dhe kjo mund të ketë një ndikim negativ tek nxënësit. Nëse ngjyra e murit është qetësuese, duke prekur syrin dhe shëndetin mendor, disponimi i mësuesit do të jetë më i balancuar.

